



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 247/A Prot.

Pogradec, më 21 . 01.2021

**VENDIM**

NR. 06 , DATË 20 / 01 /2021

**“PËR DHËNIEN E BONUSIT TË QERASË PËR FAMILJET ME PROBLEME SOCIALE DHE EKONOMIKE NË BASHKINË POGRADEC”**

Në mbështetje të Nenit 24, pika 1, të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, dhe Ligjit Nr. 22/2018 “PËR STREHIMIN SOCIAL “ përkatësisht :Neni 3, pika 3 ; Neni 33, pika 1 “PËR SUBVENCIONIMIN E QERASË” , me propozim të Kryetarit të Bashkisë,  
Këshilli Bashkiak:

**V E N D O S I**

1. T’i japë familjeve në nevojë, me probleme social-ekonomike, Bonus Qeraje sipas programit të Strehimit Social.

*Tabela Nr.1*

Emër	Mbiemër	Gjendja Sociale	Njësia Administrative	Fshati	Vlera e Kontratës së Qerasë	Afati i Kontratës	Totali
Driola	Kumria	Familje njëprindërore me 2 fëmijë, PAK	Pogradec	Buçimas	5000	18 muaj	90000
					<b>Totali :90000 lekë të reja</b>		

2. Kjo shumë prej 90000 (nëntëqind mijë) lekë, do të mbulohet nga buxheti i Emergjencave Civile në Bashkinë Pogradec.

3. Pagesa kryhet në bazë të paraqitjes së kontratave të qerasë për secilin aplikues në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financës, pranë Bashkisë Pogradec.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Strehimit, si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare, të Bashkisë Pogradec.
5. Ky vendim hyn në fuqi në momentin e lajmërimit nga strukturat përkatëse.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Sotirajq MANGËRI**

